



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I GAZETARISË DHE I KOMUNIKIMIT



**Programi: Bachelor**

**Drejtimi: Gazetari**

**Lënda: Gramatikë për gazetarë I**

*Pedagogu:* Prof. Asoc. Dr. Linda Mëniku  
*Ngarkesa:* 3 ETCS (15 javë: 2 leksione në javë)  
*Lloji i lëndës:* me detyrim  
*Viti/semestri:* I/II

**Përshkrimi:**

Studentët e gazetarisë duhet të zotërojnë gramatikën e gjuhës shqipe në një nivel të lartë, sepse aftësia e tyre për të shkruar mirë në gjuhën amtare duhet të shoqërohet dhe nga njohja sa më e mirë e të gjitha normave të shqipes, si ato drejtshkrimore, morfologjike apo sintaksore.

Lënda „Gramatikë për gazetarët I“ është konceptuar si një lëndë që fokusohet në ritrajtimin e njohurive bazë të gramatikës së shqipes nga një këndvështrim tjetër.

Studentët do të kuptojnë përmes materialit teorik dhe në veçanti të materialit të mbledhur nga media shqiptare se cilat janë shmangiet më të shpeshta nga norma morfologjike. Termet tradicionalë si emri, përemri apo folja do të përdoren thjesht në funksion të përdorimit sa më të saktë të formave të ndryshme të tyre në fjali.

Lënda “Gramatikë për gazetarët I” është ndërtuar mbi bazën e leksioneve ku temat konkrete trajtohen përmes dhënies së shembujve të shumtë. Leksionet janë konceptuar si leksione ndërvepruese ku studentët marrin pjesë në mënyrë aktive, duke sjellë shembuj të ndryshëm të marrë nga media shqiptare. Studentëve do t’u kërkohet çdo javë mbledhja paraprake e materialit nga media, në lidhje me temën përkatëse javore. Duke u nisur nga materialet e mbledhura, të bazuara kryesisht në gjetjen e shmangieve nga normativa morfologjike, në leksion do të sqarohen rregullat përkatëse, duke synuar në të kuptuarit logjik të materialit teorik dhe të atij praktik.

**2. Temat e leksioneve**

Java	Tema	Literatura
1	Gjinia e emrit. Shumësi i emrave.	<i>Gjuha letrare shqipe për të gjithë, fq.11-14.</i> <i>Gramatika e gjuhës shqipe I, fq.88-94.</i>
2	Shumësi i emrave mashkullorë.	<i>Gjuha letrare shqipe për të gjithë, fq.14-32.</i> <i>Gramatika e gjuhës shqipe I, fq.96-100.</i>
3	Shumësi i emrave femërorë. Emrat që përdoren vetëm në shumës.	<i>Gjuha letrare shqipe për të gjithë, fq.32-36.</i> <i>Gramatika e gjuhës shqipe I, fq.100-105.</i>

4	Lakimi i emrave. Lakimi i parë, lakimi i dytë, lakimi i tretë, Lakimi i katërt.	<i>Gjuha letrare shqipe për të gjithë, fq.36-44. Gramatika e gjuhës shqipe I, fq.111-117.</i>
5	Lakimi i emrave në numrin shumës. Disa vërejtje për përdorimin e trajtës. Ndërrimi i gjinisë së disa emrave mashkullorë në numrin shumës.	<i>Gjuha letrare shqipe për të gjithë, fq.44-51. Gramatika e gjuhës shqipe I, fq.117-118.</i>
6	Numërori. Përemri vetor. Vërejtje rreth disa përdorimeve të gabuara të përemrave vetorë.	<i>Gjuha letrare shqipe për të gjithë, fq.51-62. Gramatika e gjuhës shqipe I, fq.220-226.</i>
7	Përemri pronor. Lakimi i përemrave pronorë.	<i>Gjuha letrare shqipe për të gjithë, fq.63-73. Gramatika e gjuhës shqipe I, fq.232-240.</i>
8	Përdorime të gabuara të disa trajtave të përemrave pronorë. Përemri pronor i (e,të) vet.	<i>Gjuha letrare shqipe për të gjithë, fq.73-84. Gramatika e gjuhës shqipe I, fq.232-240.</i>
9	Përemri pyetës. Nyjat tek emri, mbiemri, numërori dhe përemri.	<i>Gjuha letrare shqipe për të gjithë, fq.84-99. Gramatika e gjuhës shqipe I, fq.243-246.</i>
10	Foljet kalimtare dhe jokalimtare. Diatezat e foljes. Mënyrat e foljes.	<i>Gjuha letrare shqipe për të gjithë, fq.99-109. Gramatika e gjuhës shqipe I, fq.265-266.</i>
11	Ndarja e foljeve në zgjedhime. Zgjedhimi i parë, i dytë, i tretë.	<i>Gjuha letrare shqipe për të gjithë, 110-127. Gramatika e gjuhës shqipe I, fq.277-284.</i>
12	Foljet e parregullta.	<i>Gjuha letrare shqipe për të gjithë, 127-139. Gramatika e gjuhës shqipe I, fq.277-284.</i>
13	Mënyra lidhore. Mënyra habitore. Mënyra dëshirore.	<i>Gjuha letrare shqipe për të gjithë, 139-146. Gramatika e gjuhës shqipe I, fq.291-296, fq. 320-329.</i>
14	Mënyra urdhërore. Pjesorja.	<i>Gjuha letrare shqipe për të gjithë, 146-152. Gramatika e gjuhës shqipe I, fq.298-301, fq. 331-341.</i>
15	Vërejtje rreth disa foljeve të parregullta.	<i>Gjuha letrare shqipe për të gjithë, 152-155.</i>

**Forma e kontrollit dhe vlerësimit**

- Detyrim frekuentimi në:70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- <i>Detyra e kursit</i> : rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5.	10% e notës
- <i>Kontrolli përfundimtar</i> : provim me shkrim	80% e notës
- Gjithsej:	100%

**Literatura e detyrueshme për studentin:**

Kostallari, A., Lafe. E., Totoni, M. “Gjuha letrare shqipe për të gjithë”, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1976.

**Literatura plotësuese:**

Akademia e Shkencave e Shqipërisë. “Gramatika e gjuhës shqipe I”, Tiranë, 2002.